VENDIM
Nr. 807, datë 12.12.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 9, DATË 11.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PËRFITIMIT TË VESHMBATHJEVE CIVILE PËR PUNONJËSIT E POLICISË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 9, datë 11.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët "... në masën e gjysmës së pagës mujore." zëvendësohen me "... në masën e një page mujore.".

b) Shkronja "b", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Të jetë ushtarak aktiv ose civil i emëruar në Policinë Ushtarake".

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku